REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 48124
Datë/Datum. 23.01.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Agnese Ibrahimi *Eksperte shqyrtuese*	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:* *1053/23*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.12.2023, OE ***Ejona Sh.P.K*** *ka parashtruar ankesë me nr:* ***1053/23****, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "****Instalimi i paneleve djellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubrave"*** *me nr. të prokurimit:* ***33600-23-5845-5-2-1****, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –* ***SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS.***

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 176,000 euro.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

Njoftimi për kontratë: 08.06.2023
Proces verbali i hapjes se tenderit: 30.06.2023
Vendimi i AK-së: 04.12.2023

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 62 i LPP-së
Neni 43 i LPP-së

PRETENDIMI 1)

Pasi qe OSHP mori vendim qe te cilesoje ankesen tone si te bazuar, pra qe AK nuk ka pasur te drejte te na eliminoje nga gara sepse ishim te pergjegjshem.
Si duket AK-se nuk i pelqeu vendimi i OSHP-se dhe vendosi qe te anuloje tere aktivitetin me pretendimin se tani me nuk kane buxhet per kete aktivitet.
Per te mbeshtetur kete pretendim AK bashkangjet nje leter e cila daton nga viti 2021, ku shenon se buxheti per kete projekt eshte i parapare ne vitin 2023.
Eshte teresisht normale qe ne vitin 2021 te mos parashihet se AK do te vonoje proceduren me vendime te jashteligjshme, andaj ajo leter nuk mbeshtet asgje.

Sipas LPP dhe Rregullores se Prokurimit publik, perkatesisht ***Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit*** dhe ***Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit*** , egzistojne vetem disa kushte qe nje aktivitet te anulohet, dhe ato kushte nuk jane plotesuar asnjera per kete aktivitet.

Per kete qeshtje ne kemi kerkuar edhe interpretim nga KRPP, ku KRPP na pergjigjet se ne LPP eshte shume e qarte se cilat kushte duhet te plotesohen per anulimin e nje aktiviteti publik, dhe mungesa e buxhetit nuk eshte asnjera prej atyre kushteve.

Bashkangjitur gjeni edhe interpretimin e KRPP lidhur me kete qeshtje.

3.KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
1. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë kontrata në vlerë prej 200.000 Euro për punë të ngjashme të realizuar me sukses në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë	1. Një listë ku saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të punëve të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës, vendin, datën dhe pranuesin. 1.1 Listës duhet bashkangjitur si dëshmi - kur puna është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij aktiviteti shërben kopja e certifikatës, raport të pranimi, referencës të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. Te gjitha këto dëshmi duhet te kenë vlerën e realizuar. Kur puna është bërë për punedhenesin privat, për dëshmi të këtij aktiviteti shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga punemarrsi dhe punedhensi qe deshmon se puna eshte perfunduar me sukses.
2. Operatori Ekonomik duhet të ketë staf mbikqyrës per realizimin e projektit, perfshier stafin mbikqyres menaxherët. 2.1.Një (1) inxhinier i makinerisë drejtimi termoenergjitikë me termoteknikë	2. Lista e stafit, mbikëqyrësve - menaxhereve (e vulosur dhe e nënshkruar) 2.1. Diploma e inxhiniert të makinerisë drejtimi termoenergjitikë me termoteknikë kopje e noterizuar, kontrata e punës ose para kontratë. Noterimi i diplomes duhet te jete jo me i vjetër se 3 muajt e fundit).

4.RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Jus
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria Qendrore-Prishtinë/Zyra e Prokurimit
Zyra e Prokurimit

Nr. Prot. ZP- /03/2023
Datë: 15.12.2023.

~~Në mbështetje të nenit 108/A pika 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës~~ Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 8 të Rregullave për parashtrimin ankesave të miratuar nga KRPP-ja, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës 11.12.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik " Ejona SHPK- Pejë," pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit "Instalimi i paneleve djellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q.K Dubravë", Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, nxjerr këtë:

VENDIM
MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM SI TË PABAZË

I. Refuzohet kërkesa e propozuar për shqyrtim, e Operatori Ekonomik, "Ejona SHPK-Pejë", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Instalimi i paneleve djellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubrave", me nr. të prokurimit: 33600-23-5845-5-2-1, të shpallur nga Autoriteti Kontraktues – Shërbimi Korrektues i Kosovës

II. Vërtetohet, vendimi i Autoritetit Kontraktues - SHKK, për anulim te aktivitetit te prokurimit "Instalimi i paneleve djellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubrave".

III. Obligohet, Autoriteti Kontraktues – Shërbimi korrektues i Kosovës, që refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të ja komunikoj parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5.INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

6.VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

7.VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

8.ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

9.PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES OE Ejona Sh.P.K

***Sqarim hyrës**: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, si palë e pakënaqur me njoftimin e vendimit të AK-së për anulim të procedurës së prokurimit. Pretendimet të cilat janë ngritur nga OE ankues, për to ka dhënë përgjigje eksperti shqyrtues si më poshtë.*

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: *"Pasi qe OSHP mori vendim qe te cilesoje ankesen tone si te bazuar, pra qe AK nuk ka pasur te drejte te na eliminoje nga gara sepse ishim te pergjegjshem. Si duket AK-se nuk i pelqeu vendimi i OSHP-se dhe vendosi qe te anuloje tere aktivitetin me pretendimin se tani me nuk kane buxhet per kete aktivitet. Per te mbeshtetur kete pretendim AK bashkangjet nje leter e cila daton nga viti 2021, ku shenon se buxheti per kete projekt eshte i parapare ne vitin 2023. Eshte teresisht normale qe ne vitin 2021 te mos parashihet se AK do te vonoje proceduren me vendime te jashteligjshme, andaj ajo leter nuk mbeshtet asgje. Sipas LPP dhe Rregullores se Prokurimit publik, perkatesisht Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit dhe Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit , egzistojne vetem disa kushte qe nje aktivitet te anulohet, dhe ato kushte nuk jane plotesuar asnjera per kete aktivitet. Per kete qeshtje ne kemi kerkuar edhe interpretim nga KRPP, ku KRPP na pergjigjet se ne LPP eshte shume e qarte se cilat kushte duhet te plotesohen per anulimin e nje aktiviteti publik, dhe mungesa e buxhetit nuk eshte asnjera prej atyre kushteve. Bashkangjitur gjeni edhe interpretimin e KRPP lidhur me kete qeshtje."*

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së edhe më herët në lidhje me eleminimin nga aktiviteti i prokurimit, ku eksperti shqyrtues paraprak dhe paneli shqyrtues përmes Vendimit me numër 2023/0681 kanë aprovuar ankesën e OE ankues si të

bazuar dhe e kanë kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim. Pas rivlerësimit AK merr vendim për anulim të këtij aktiviteti me arsyetimin se AK nuk ka ndarje buxhetore për vitin 2024 dhe 2025 për këtë aktivitet prokurimi, andaj për arsye buxhetore bënë anulim të aktivitetit edhe pse pas rivlerësimit AK, OE-në ankues, nga operator i eleminuar e shpallë si operator të pasuksesshëm.
Duke u bazuar në nenin 62 të LPP-së- Përfundimi i aktivitetit të prokurimit, ky nen tregon arsyet se kur një Autoritet Kontraktues duhet të përfundoj një aktivitet prokurimi, arsyet e anulimit përmendën edhe përmes nenit 43 të RRPP-së. OE ankues i është drejtuar edhe KRPP-së për interpretim të anulimit, ku të njëjtit kanë kthyer përgjigje se për t'u anuluar një aktivitet prokurimi duhet që arsyet të jenë në përputhje me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-së, ku caktohen kushtet në të cilat një aktivitet mund të përfundoj. Asnjë nga arsyet e këtyre neneve, nuk parashohin arsyetimin e anulimit i cili lidhet me mjetet buxhetore. Përmes sistemit e-prokurimi, tek Deklarata e nevojave, AK ka deklaruar shumën e paraparë të ndarë për këtë aktivitet prokurimi dhe arsyetimi se pas 6 muajsh ky prokurim duhet të anulohet për shkak se AK nuk ka mjete buxhetore për vitin pasues, sipas ekspertit nuk është aspak në rregull dhe aspak serioz.

Mendimi i ekspertit është se ndarja e mjeteve të caktuara për një aktivitet i cili nuk është realizuar në vitin paraprak, mund të bëjë bartjen e mjeteve për të njëjtin aktivitet në vitin pasues siç e parasheh edhe Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 (LIGJI NR. 08/L-193). Mjetet të cilat janë ndarë tashmë, është dashur të barten në vitin pasues, pasi që është e parashikuar që jo gjithmonë fazat e vlerësimit të aktivitetit të prokurimit mund të përfundohen brenda kohës së parashikuar. Po ashtu eksperti pasqyron se ky aktivitet i filluar shihet të jetë i domosdoshëm për plotësimin e nevojave të këtij institucioni i cili është i nevojshëm të realizohet. Andaj, eksperti sqaron edhe njëherë se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 62 të LPP-së në anulim të këtij aktiviteti dhe nga kjo çfarë kemi sqaruar më lartë vlerësojmë që ky pretendim është i bazuar.

10.MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – EJONA SH.P.K*

Agnese Ibrahimi